



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 455/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, përkitazi me ankesën e Koalicionit për Kosovën e Re paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 13.12.2010, mori:

### VENDIM

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e Koalicionit për Kosovën e Re

### ARSYETIMI

Më datë 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga koalicioni politik për Kosovën e Re, në të cilën theksohet se në shkollën “Zenel Hajdini” në dhomen nr 3, llampat identifikuese nuk kanë punuar si dhe ka pasur përfaqësues të partive politike që po kërkonin të ndërpritej procesi i votimit me qëllim që të tejkaloheshin këto probleme.

Në mbështetje të pretendimeve parashtresuesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshte:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e palejuar**

PZAP-i vlerëson se ankesa e Koalicionit Kosova e Re paraqitur kundrejt KQZ-se është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe funksionimin e llompave identifikuese përgjate dites së zgjedhjeve në 12.12.2010. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 455/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

